



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

PLANI I PUNËS PËR PJESËN E MBETUR TË VITIT 2026

Podujevë, 18 gusht 2026

Komiteti për Komunitete, në pjesën e mbetur të vitit 2026, angazhimin punët dhe aktivitetet do t'i fokusoj në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi mbi bazën e dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe detyrave të përcaktuara me këtë Plan, në veçanti:

- Implementimi i Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Komunës së Podujevës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.
 - Detyrë e përhershme.
- Mbikëqyrja në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizmin e plotë të të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës.
 - Detyrë e përhershme.
- Angazhim në ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteteve dhe vlerave etnike, kulturore, fetare, mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike.
 - Detyrë e përhershme.
- Avancimi i marrëdhënieve të mira ndëretnike.
 - Detyrë e përhershme.
- Rekomandime të masave, organeve përkatëse, për çështje për të cilat gjatë punës dhe aktiviteteve vlerëson se janë të nevojshme në realizmin e plotë të të drejtave të garantuara ligjore si dhe dispozitave të Konventave përkatëse ndërkombëtare.
 - Detyrë e përhershme
- Përcjellja e vazhdueshme e institucioneve të Komunës në aspektin e respektimit të dispozitave ligjore, politikave dhe praktikave të Komunës si dhe aktivitetet në realizmin e plotë të të drejtave të bashkësive etnike.
 - Detyrë e përhershme
- Kujdesi i vazhdueshëm që në Komunë gjuhët zyrtare të jenë në përdorim të barabartë për pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike, të kenë status të njëjtë në punët dhe aktivitetet e organit përfaqësues dhe organit të Ekzekutivit të Komunës si dhe që çdo qytetarë të ketë të drejtën e shprehjes së lirshme pran institucioneve të Komunës në gjuhët dhe alfabetet zyrtare.
 - Detyrë e përhershme
- Kujdesi për respektimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes, planifikimeve dhe përgjegjësitë në kuadër të kompetencave të Komunës.
 - Detyrë e përhershme

- Kujdesi për përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit të Komunës për punë transparente dhe krijimin e mundësive dhe mekanizmave për informim të mirëfilltë të pjesëtarëve dhe subjekteve të të gjitha komuniteteve, për punët dhe aktivitetet e përditshme të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit në përgjithësi.
 - Detyrë e përhershme
- Shqyrtimi i propozim Rregulloreve, Planeve dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat procedohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
 - Detyrë e përhershme sipas procedimit dhe afateve kohore të konsultimeve.
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të cilat i drejtohen këtij Komiteti.
 - Detyrë e përhershme
- Shqyrtimi i zbatimit të Planit të punës për pjesën e mbetur të vitit 2026.
 - ❖ Mbledhja e muajit gusht 2026

Ndër aktivitetet e mësipërme, Komiteti për Komunitete planifikon edhe:

- Vizitë e komuniteteve jo shumicë në lagjen ku jetojnë në rrugën “Xhafer Meta”, në Podujevë.
 - ❖ Më 13.09.2026 (për kohën, vendin dhe çështjet tjera mbetet që Kryesuesi i Komitetit të ketë konsultime dhe kontakt me anëtarët e Komitetit, ndërsa për njoftimin e familjeve në atë lagje kujdesen anëtarët/et përkatës të Komitetit që banojnë dhe jetojnë në lagje)
 - Përgatitja e Informatës rreth kësaj vizite, për mbledhjen e radhës të Komitetit
- Vizitë e komuniteteve jo shumicë në lagjen ku jetojnë në rrugën “Ali Ajeti”, në Podujevë.
 - ❖ Më 02.11.2026 (për kohën, vendin dhe çështjet tjera mbetet që Kryesuesi i Komitetit të ketë konsultime dhe kontakt me anëtarët e Komitetit, ndërsa për njoftimin e familjeve në atë lagje kujdesen anëtarët/et përkatëse të Komitetit që banojnë dhe jetojnë në atë lagje)
 - Përgatitja e Informatës rreth kësaj vizite, për mbledhjen e radhës të Komitetit
- Vizitë e komuniteteve jo shumicë dhe shkollat fillore në fshatrat Batllavë dhe Orllan.
 - ❖ Më 12.10.2026 (për kohën, vendin dhe çështjet tjera mbetet që Kryesuesi i Komitetit të ketë konsultime dhe kontakt me menaxhmentin e shkollave përkatëse)
 - Përgatitja e Informatës rreth kësaj vizite, për mbledhjen e radhës të Komitetit
- Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 me theks në suksesin dhe vijueshmërinë e nxënësve të komuniteteve Ashkali, Rom dhe Egjiptas.
 - ❖ Mbledhja e muajit: kurdo që parashihet e nevojshme

- Informatë për fillimin e vitit shkollor 2026/2027 me theks lidhur me nxënësit e komuniteteve Ashkali, Rom dhe Egjiptas.
 - ❖ Mbledhja e muajit: kurdo që parashihet e nevojshme
- Identifikimi i personave të komuniteteve jo shumicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor
 - ❖ Mbledhja e muajit: kurdo që parashihet e nevojshme
- Vizitë në shkollat fillore të Mesme të Ulëta: “Naim Frashëri; “Dr. Ibrahim Rugova” “Shaban Shala, në Podujevë.
 - ❖ Sipas mundësive dhe në koordinim mes anëtarëve të Komitetit si dhe në mes drejtorëve të këtyre shkollave (për kohën, vendin dhe çështjet tjera mbetet që Kryesuesi i Komitetit t'i njoftoj menaxhmentin e shkollave përkatëse dhe anëtarët e Komitetit)
 - *Përgatitja e Informatës rreth kësaj vizite, për mbledhjen e radhës*
- Shqyrtimi i mundësive për gjetjen e donatorëve eventual për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje gjatë dimrit për familje me nevojë të komuniteteve jo shumicë.
 - ❖ 06 tetor 2025
- Analizë e realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2026,
- Shqyrtimi i Informatave të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, sipas nevojës.
- Shqyrtimi i realizimit të rekomandimeve të këtij Komitete, drejtuar strukturave relevante të nivelit lokal dhe nivelit qendror, çdo gjashtë muaj.

Në funksion të shkëmbimit të përvojave me Komitetet për Komunitete, vizita në Komunitet e Republikës së Kosovës,

- Varësisht mundësive dhe kontaktimeve me përfaqësues të Komiteteve për Komunitete nëpër Komuna, dhe dakordimit mes anëtarëve të komitetit për Komunitete të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, në bashkëpunim dhe koordinim me anëtarët e Komitetit i cakton datat e vizitave sipas këtij plani.

Bashkëpunimi

Komiteti për Komunitete, gjatë vitit 2025, në vazhdimësi do të bashkëpunoj dhe aktivitetet do t'i bashkërendoj me:

- Institucionet relevante të Komunës, në veçanti me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
- Zyrën për Komunitete në kuadër të Zyrës për Komunitete
- OSBE-në,

- KFOR-in,
- Njësitin për komunitete të Stacionit të Policisë në Podujevë dhe Policinë rajonale kufitare.
- Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi të Komunës së Podujevës,
- OJQ-të e ndryshme, për mbështetje në implementimin e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas
- Subjektet tjera relevante.

Mbledhjet

Komiteti për Komunitete do të bëjë përpjekje që të mbajë mbledhje sipas nevojës dhe së paku 1 (një) mbledhje gjatë çdo muaji në këtë pjesë të mbetur të vitit 2026.

Nr.Prot. 01-016/01-0050039/26
Podujevë, datë; 18 gusht 2026

Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi

